



**Bordi  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**VENDIM**

*Nr. 139, Datë 06.09.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“HYDRO POWER PLANT OF KORÇA” SH.P.K PËR VENDOSJE TË PENGUT MBI  
KUOTAT E KAPITALIT, SENDET E LUAJTSHME SI DHE HIPOTEKËN MBI  
SENDET E PALUAJTSHME TË SHOQËRISË**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licensuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016, si dhe të pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.99 datë 17.06.2016 dhe nenit 19 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit” si më poshtë:

*Neni 7, pika 1, gërma “a- Një ekstrakt historik i shoqërisë tregëtare të të licensuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit : Plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma “b- Veprimtaria e licensuar : Plotësuar. (Subjekti është i licensuar nga ERE në aktivitetet e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.)*

*Neni 7, pika 1, gërma “c- Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve: Plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma “d- Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë, që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare. Plotësuar. (Banka përfutuese është Intesa San Paolo Albania dhe subjekti ka depozituar dokumentacion të detajuar mbi përshkrimin e veprimtarisë së saj).*

*Neni 7, pika 1, gërma “e- Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma “f- Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit, plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma "g- Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma "h- Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen, plotësuar.*

*Neni 7, pika 1, gërma "i" Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit : Pa plotësuar*

*Neni 7, pika 1, gërma "j- Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt : Subjekti "Hydro Power Plant of Korça" sh.p.k. ka një transferim të mëhershëm asetesh për të cilin ERE është shprehur me vendimin nr. 171 Datë 24.12.2012, Për miratimin e kërkesës së e shoqërisë "Hydro Power Plant of Korça" sh.p.k. për lënje peng si kolateral të asetëve të saj pranë BERZH".*

*Neni 7, pika 3- Subjektet koncensionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar në ERE miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për këtë vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.*

*Objekt i Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licensuarit" të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016 janë : shitja, dhënia me qera, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose asetëve fikse të të licensuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.*

*Kuotat e kapitalit dhe sendet e paluajtshme që nuk i shërbejnë aktivitetit të licencuar nuk janë objekt shqyrtimi nga ERE.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Hydro Power Plant of Korça"sh.p.k për vendosje të pengut mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.
2. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Hydro Power Plant of Korça" për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit dhe sendet e luajtshme.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE**  
**Petrit AHMETI**